

Vend. K

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
PRESTIGE ESPALB SH.P.K**

Sot me date 10.10.2023 (dymije e njetzet e tre), para meje Kontabilistit **Lorenc Ajderaj** me adrese: Lagjja " Uznove ", rruga " 28 Nentori ", Zone Kadastrale 8504, Nr pasurie 150/113-N2, godina tre kateshe me nr.35, kati i pare Berat, u paraqiten themeluesit:

- **Znj. Veronica Barragan Garcia**, atesia Saturnino, shtetase spanjolle, lindur me 18.07.1987 ne Leganes (Madrid) dhe banues ne Getafe Madrid Spanje, madhor me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporte Nr. PAM659846 me nr personal me Nr.51471502D

Bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare » i ndyshuar me ligjin nr. 129 / 2014, Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 Ne Qendrën Kombëtare të' Biznesit', _LIGJ Nr. 131 /2015 per QENDREN KOMBETARE TE BIZNESIT, me vullnetin e tyre te lire, kane vendosur te perpilojne Aktin e Themelimit te mëposhtem te nje shoqerie me përgjegjesi të kufizuar (me poshte "Shoqeria"), aktiviteti i se ciles do të rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi dhe Statuti i Shoqerise.

KREU I

EMRI,OBJEKTI,KOHEZGJATJA SELIA

NENI 1 - EMRI

Emri i shoqerise eshte: **PRESTIGE ESPALB SH.P.K**

NENI 2 - SELIA

Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Polican, sheshi Tomorri, rruga Miqesia, Zona Kadastrale 3019, me nr. Pasurie 12/182+2-8 PO-E-A,kodi postar 5404.

NENI 3 - KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimarise se shoqerise eshte pa afat.

NENI 4 - OBJEKTI I SHOQERISE

Shoqeria do te ushtroje aktivitet:

Dhenie apartamente me qira .Tregeti me pakice e shumice artikuj te ndryshem,Import-eksport i tyre.Bar-Kafe .Ushqim i shpejt Fast Food. Veprimtari te ndryshme ne fushen e tregetit sipas legjislacionit ne fuqi.

KREU II

KAPITALI

NENI 5 – KAPITALI THEMELTAR

Kapitali baze fillestar i shoqerisë PRESTIGE ESPALB SH.P.K. eshte 600,000.00 (Gjashteqinde mije) leke dhe tëresisht i paguar nga ortaku i vetem i shoqerise sipas pjesëmarrjes ne kapitalin e shoqërisë.

Kontributi i ortakut përbën kapitalin themeltar dhe te regjistruar te shoqerise: PRESTIGE ESPALB SH.P.K. Kapitali shoqerise PRESTIGE ESPALB SH.P.K perbehet nga nje kuote si me poshte vijon:

a) **Kuota I** e cila përfaqeson 100 (njqind) % të kapitalit me të gjitha te drejtat dhe detyrimet në pronesi /emer te **-Znj. Veronica Barragan Garcia** identifikuar si me siper.

NENI 6 - KONTRIBUTI

Kapitali baze përbehet nga kontributi i ortakut si me vijon:

- **Znj. Veronica Barragan Garcia** kontribon me 100 % ne kapitalin e shoqërisë PRESTIGE ESPALB SH.P.K dhe ka / zoteron me te drejta dhe detyrime te plota 100 % te kuotave te kapitalit te shoqerise "PRESTIGE ESPALB " SH.P.K.

NENI 7 - TRANSFERIMI I PJESVE TE KAPITALIT

Pjeset e Kapitalit i transferohen te tretteve sipas parashikimeve te Statutit.

NENI 8 - ADMINISTRATORET

Administrator i pare i shoqerise qe zgjidhet per nje afat pese vjecar eshte:

Znj. Veronica Barragan Garcia, atesia Saturnino, shtetase spanjolle, lindur me 18.07.1987 ne Leganes (Madrid) dhe banues ne Getafe Madrid Spanje, madhor me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporte Nr. PAM659846 me nr personal me Nr.51471502D.

Administratori do te ushtroje te gjitha kompetencat per administrimin e zakonshem te shoqerise, ne perputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Ky akt, u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe me vlere te njejte ligjore.

Ky akt pasi ju lexua prej meje, Kontabilistit dhe pasi u sigurova qe e kuptojne teresisht dhe e gjejne ne perputhje me vullnetin e tyre te lire, lejoj nenshkrimin dhe e legalizoj ate sipas ligjit.

ORTAKE E VETEM I SHOQERISE
Veronica BARRAGAN GARCIA

Veronica Barragan Garcia



KONTABEL I MIRATUAR
Lorenc AJDERAJ

